

Inspektori i Përgjithshëm i Administratës, Shefi i Inspektoratit të Përgjithshëm të Administratës Franceze, në tekstin e mëtejme "IGA",

në njërën anë,

Inspektori i Përgjithshëm, Shefi i Inspektoratit Qendror Shqiptar, në tekstin e mëtejme "IQ"

nga ana tjetër,

kanë rënë dakord si më poshtë:

duke marrë parasysh projekt-reformën e ligjit nr. 10 443, datë 16 qershor 2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe aspektet organizative dhe praktike të zbatimit të kësaj reforme, siç përcaktohet nga Inspektori i Përgjithshëm, shefi i IQ Shqiptar:

- është vendosur parimi i mbështetjes nga IGA franceze të transformimeve të nxitura nga reforma, përmes një bashkëpunimi shumëvjeçar me Inspektoratin Qendror;
- kjo mbështetje do të përfshijë:
 - o Hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, te nevojshme për zbatimin e versionit të ri të ligjit të lartpërmendur, në përputhje me legjislacionin acquis-Europian ;
 - o Evoluimi i statusit të inspektorit, procedurat e rekrutimit dhe administrimit të tyre, si dhe çështjet lidhur me pagat;
 - o Trajnimi i stafit të inspektimit në praktikën e "biznesit" të zbatuara nga IGA;
 - o Mbajtja e kontakteve të krerëve të Inspektorateve Shtetërore me korrespondentët e tyre teknik në Francë;
- Marrëveshjet e hollësishme për funksionimin e një bashkëpunimi të tillë do të përcaktohen në një memorandum bashkëpunimi, përmbajtja e të cilit do të hartohet së bashku nga të dy departamentet para fundit të vitit 2017;

- Memorandumi do të nënshkruhet nga dy Inspektorët e Përgjithshëm në Tiranë, deri në fund të Janarit 2018, me miratimin paraprak të autoriteteve të tyre kombëtare.

Kjo Marrëveshje do të publikohet në dy gjuhët kombëtare të nënshkruesve të inspektorateve përkatëse.

Paris, 06 Tetor 2017

Për Inspektoratin e Përgjithshëm
të Administratës
Republikës Franceze



Michel ROUZEAU

Udhëheqës i Departamentit
të Inspektoratit të Përgjithshëm
Të Administratës Franceze

Për Inspektoratin Qendror
të Republikës së Shqipërisë

Shkëlqim HAJDARI

Inspektorin e Përgjithshëm
Inspektoratit Qendror

